




Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë  
Uprava za Optikë, Administrativë Poslova

31 Nr./Br. 413/01-12368  
Data 08.05.2018  
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Njësia org.	Numri	Shtypja	Vlera
	1248		



KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë

Komuna Gjakovë

**MARRËVESHJE**  
**PËR BASHKËFINANCIM NË REALIZIMIN E PROJEKTEVE NE UJESJELLES DHE**  
**KANALIZIM PER VITIN 2018 NË KOMUNEN E GJAKOVËS**

E lidhur me datën 08.05.2018 në mes të palëve :

**KRU. "Gjakova" Sh.A.** - Gjakovë, të cilën e përfaqëson, Kryeshefi Ekzekutiv z.Ismet Ahmeti , Ofruesi i Shërbimeve të ujit të pijes.

**Komuna e Gjakovës** ,të cilën e përfaqëson ,Kryetari i Komunës z.Ardian Gjini

Palët ,me marrëveshje ,me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore ,

**Vendosen**

Të lidhin këtë marrëveshje me kushtet e mëposhtme :

**Neni 1**  
**Lënda dhe qëllimi i marrëveshjes**

Lëndë e kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i palëve në Marrëveshje në realizimin e projekteve në Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit për vitin 2018 në Komunën e Gjakovës , me qëllim të furnizimit të plotë dhe kualitativ të banorëve të Komunës së Gjakovës me këto shërbime .

**Neni 2**  
**Obligimet e palëve ne marrëveshje**

1.1. Palët ne marrëveshje , Komuna e Gjakovës dhe KRU "Gjakova"Sh.A.-Gjakovë, u dakorduan që të bashkefinancojnë në realizimin e projekteve në ndërtimin e rrjetave të reja të ujësjellësit dhe kanalizimeve si dhe rehabilitim e rrjetave të vjetra qe do të realizohen në Komunën e Gjakovës, nga KRU "Gjakova" SH.A. gjatë vitit 2018.

1.2. Ne realizimin e projekteve si ne paragrafin 1.1, te këtij nenii, pala ne Marrëveshje Komuna e Gjakovës, nga buxheti i saj do të participoj me 49% të shumës totale vjetore të financimit të projekteve , ndërsa KRU"Gjakova" SH.A. me 51% të shumes totale vjetore të financimit.

1.3. Procedurën e prokurimit në realizimin e projekteve si në paragrafin 1.1, të këtij nenit përzgjedhjen e operatorit-kryesit të punimeve , do të zhvillohet nga KRU "Gjakova"Sh.A.

1.4. Në vitet në vijim palët në marrëveshje u pajtuan që ti koordinojnë aktivitetet e parapara për investime, në mënyrë që të planifikohen paraprakisht investimet në sferën e realizimit të ndërtimit të rrjetave të reja të ujësjellësit dhe kanalizimeve si dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese.

1.5. Rrjetat e reja të ndërtuara me bashkëfinancim të dy palëve, palët në marrëveshje u dakorduan që të jenë në pronësi të KRU "Gjakova" Sh.A. si ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit .

1.6. Komisionet për pranimin teknik te objekteve të ujësjëllësit të ekzekutuara me bashkëfinancim, do te kenë përbërje (dy anëtar nga KRU "Gjakova" dhe një anëtar nga Komuna e Gjakovës).

### **Neni 3 Rregullat tjera**

3.1 Palët duhet të respektojnë detyrimet që rrjedhin për ta nga kjo Marrëveshje sipas dispozitave që parashikohen në të .

3.2 Për çdo problem, palët duhet të komunikojnë me njëra tjetrën dhe të mundohen ti zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre dhe vetëm në pamundësi ti drejtohen Gjykatës Themelore .

3.3 Kjo marrëveshje është lëshuar në dy kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbajt nga një kopje.

3.4 Kjo marrëveshje, hynë në fuqi dhe duhet të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj dhe mund të vazhdohet edhe vitet në vijim me dakordimin e palëve

### **PALËT KONTRAKTUESE**

Kompania Rajonale e Ujësjellësit  
"GJAKOVA" Sh.A.-Gjakovë

  
z. Ismet Ahmeti

